



FOTOGRAFIA: DINI BEGOLLI – PROJEKTI VIP DINARICA

# PËRMIRËSIMI I BASHKËPUNIMIT - BULETINI

I IPA Programeve të Bashkëpunimit  
ndërkufitar Mali i Zi - Shqipëri dhe Mali i  
Zi - Kosovë 2014-2020

## Shkurt 2018

PËRMBAJTJA

## Prezantimi i buletinit për IPA programin e BNK-së MZ-SHQ dhe MZ-KS

Ky buletin është përgatitur me qëllim për të informuar publikun e gjerë për aktivitetet dhe ngjarjet që zbatohen në kuadër të Programeve IPA BNK Mali i Zi – Shqipëri dhe Mali i Zi – Kosovë\* 2014-2020.

Më shumë informacione për programet mund t'i gjeni më poshtë.

### Programi IPA i BNK-së Mali i Zi - Shqipëri 2014-2020

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të promovojë dhe të forcojë marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe zhvillimin socio-ekonomik të rajoneve kufitare, përmes valorizimit të potencialeve turistike dhe një zhvillimi ekonomik, social dhe mjedisorë të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, në respekt të trashëgimisë së përbashkët kulturore dhe natyrore.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

### Programi IPA i BNK-së Mali i Zi - Kosovë 2014-2020

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të përmirësojë standardet dhe cilësinë e jetës së njerëzve në zonën e programit nëpërmjet një zhvillimi ekonomik, social dhe mjedisorë të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të rajonit në respekt të trashëgimisë së përbashkët kulturore dhe natyrore.

Ky publikim është prodhim i mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e saj është përgjegjësi e Sekretariatit të Përbashkët Teknik të Programeve IPA BNK Mali i Zi – Shqipëri dhe Mali i Zi – Kosovë 2014-2020 dhe nuk paraqet domodoshmerisht mendimet e Bashkimit Evropian.

Bashkimi Evropian  
IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR  
MALI I ZI - SHQIPËRI 2014-2020

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

- » Prezantimi i buletinit për IPA Programet BNK MZ-SHQ dhe MZ-KS.....1
- » Programi IPA BNK Mali i Zi - Kosovë 2011-2013 i përfunduar .....2
- » Vizitë pune e Ministrit Pejoviq në Sekretariatit e Përbashkët Teknik për Programet e BNK Mali i Zi-Shqipëri dhe Mali i Zi – Kosovë.....3
- » Seminari Rajonal i mbajtur në Tiranë në kuadër të Programeve të Bashkëpunimit Territorial .....3
- » Projektet e financuara nën Thirrjen e Parë për Projekt- propozime brenda IPA BNK Programit Mali të Zi - Kosovë 2011-2013 .....4
- » Praktikat më të mira - Projektet e zbatuara në kuadër të Programit IPA BNK Shqipëri- Mali i Zi 2007-2013 .....8
- » Takimet e mbajtura në kuadër të IPA BNK Programeve MZ-SHQ dhe MZ-KS 2014-2020 .....9
- » Zbatimi i programeve deri në fund të vitit 2017.....9

\*Ky shënim është pa paragjykim të pozicioneve për status dhe është në linjë me RKS KB 1244 dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.



Ky projekt është i financuar nga Bashkimi Evropian



**MNE – ALB**

IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR  
MALI I ZI - SHQIPËRI 2014-2020



**MNE – KOS**

IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR  
MALI I ZI - KOSOVË 2014-2020

## Programi IPA BNK Mali i Zi - Kosovë 2011-2013 ka përfunduar

Me 19 Janar 2018 në Podgoricë është mbajtur Konferenca përmbyllëse e Programit IPA Bashkëpunimi Ndërkufitar Mali i Zi – Kosovë 2011-2013 gjatë të cilës janë prezantuar rezultatet e arritura të këtij programi.



Fjala hyrëse është mbajtur nga Ministri për Çështje Evropiane të Malit të Zi, Aleksandar Andrija Pejoviq i cili i theksoi arritjet kryesore në kuadrin e zbatimit të nëntë projekteve, me shumë totale të financuar prej 3.7 milion euro. Këto projekte kanë kontribuar në arritjen e qëllimeve konkrete të lidhura me zhvillimin ekonomik, mjedisorë, mbrojtjen dhe promovimin e biodiversitetit, promovimin e burimeve të përbashkëta natyrore në kufi, siç janë bujqësia, pylltaria dhe zhvillimi i turizmit.



Në emër të Strukturës Operative nga Kosova, foli Zëvendësministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Beqir Fejzullahu i cili fillimisht falënderoi Ministrinë



për Çështje Evropiane të Malit të Zi dhe Delegacionin e Bashkimit Evropian duke vlerësuar rolin dhe rëndësinë e këtij programi përmes zbatimit të qëllimeve të



përgjithshme të bashkëpunimit ndërkufitar, fuqizimin e gjendjes socio-ekonomike brenda zonës duke nxitur bashkëpunimin dhe iniciativa të përbashkëta në sektorë të tillë siç është mbrojtja e mjedisit të qëndrueshëm, bujqësia dhe pylltaria, si dhe të ofertave turistike.



Në këtë ngjarje pjesëmarrës ishte edhe Shefi i Sektorit të Bashkëpunimit në Delegacionin e Bashkimit Evropian në Mal të Zi, Hermann Shpitz, i cili vlerësoi lartë arritjet e përbashkëta të këtij programi, si dhe arritjet lidhur me bashkëpunimin midis dy vendeve përmes një partneriteti të përbashkët ndërkufitar.



Më pas, përfaqësuesit e organizatave dhe institucioneve që ishin përfitues të këtij programi morën pjesë në diskutimin e panelit dhe prezantuan arritjet, rezultatet dhe sfidat me të cilat janë ballafaquar në procesin e zbatimit të projektit. Ata gjithashtu vlerësuan pozitivisht bashkëpunimin gjatë aktiviteteve të zbatuara me partnerët e tyre të projektit nga komunat e Kosovës.



Në këtë konferencë gjithashtu morën pjesë edhe përfaqësuesit e ministrive nga Mali i Zi dhe Kosova, kryetarët të komunave, përfaqësuesit e institucioneve lokale dhe shtetërore, ndërmarrjeve publike, përfitues të projekteve dhe përfaqësues të shoqërisë civile dhe të medieve nga Mali i Zi dhe Kosova.

## Vizitë pune e Ministrit Pejoviq në Sekretariatit të Përbashkët Teknik për Programet e Bashkëpunimit Ndërkufitar me Kosovën dhe Shqipërinë

Themelimi i Sekretariatit të Përbashkët Teknik (SPT) për Programet e Bashkëpunimit Ndërkufitarë Mali i Zi – Shqipëri dhe Mali i Zi



– Kosovë për vitet 2014 – 2020, me seli në Podgoricë, ka dëshmuar të jetë mbështetje e rëndësishme në zbatimin e këtyre programeve bilaterale, u theksua në takimin e punës të Ministrit për Çështjeve Evropiane, Aleksandar Andrija Pejoviq dhe bashkëpunëtorëve të tij me Drejtuesen e SPT-së, Sanja Todoroviq dhe stafin e saj.

Bashkëbiseduesit u pajtuan që një numër i aktiviteteve të SPT-së, duke përfshirë sesionet informuese, trajnimet dhe forumet e kërkimit të partnerëve i kanë përforcuar ndjeshëm kapacitetet e përfituesve dhe të aplikuesve potencial, duke kontribuar kështu në mënyrë efikase në tërheqjen e më shumë fondeve që janë në dispozicion dhe në përgatitjen e projekteve më cilësore.

Ministri Pejoviq shprehu kënaqësinë e tij me mbështetjen në zbatimin e suksesshëm të të dy programeve bilaterale përmes të cilave përfituesit kanë fonde në dispozicion në shumën prej rreth 5 milion eurosh brenda thirrjes së parë për projekt propozimet. "Puna e përbashkët e Ministrisë së Çështjeve Evropiane, Ministrisë së Financave dhe SPT-së u ka mundësuar këtyre programeve të jenë më të avancuarit në rajon", tha ministri Pejoviq.

shprehu shpresën se në periudhën e ardhshme do të ketë më shumë projekte cilësore në fushën e punësimit, mbrojtjes së mjedisit dhe promovimit të turizmit, të cilat mund të kontribuojnë në zhvillimin e mëtejshëm të zonës së programit.

Drejtuesja e SPT-së, Sanja Todoroviq, ka përkujtuar që kjo strukturë është themeluar në Janar të vitit 2016 dhe se është Sekretariati i parë për bashkëpunime bilaterale në rajon. Nga që Malit të Zi, në kuadër të këtyre dy programeve të bashkëpunimit ndërkufitar, i është besuar të menaxhojë në mënyrë indirekte fondet e BE-së, funksioni i Sekretariatit imponon veprime më të përgjegjshme në drejtim të bashkëpunimit më intensiv me përfituesit e projektit nga të tre vendet, me qëllim të avancimit të mëtejshëm të procesit të realizimit të aktiviteteve të parashikuara.

## Seminari Rajonal u mbajt në Tiranë në kuadër të Programeve të Bashkëpunimit Territorial

Nën kujdesin e Ministrisë për Evropën dhe Punëve të Jashtme, më 17 janar 2018, në Tiranë u organizua Seminari Rajonal në kuadër të Programeve të Bashkëpunimit Territorial me qëllim të promovimit të këtyre programeve si dhe forcimin e rolit të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme në fushën e koordinimit të ndihmës së BE-së.

Seminari Rajonal i titulluar "Bashkëpunimi territorial, perspektivat e reja për fuqizimin e

integritimit", ishte një aktivitet një-ditorë dhe u përshëndet nga aktorë të ndryshëm nga Shqipëria, duke përfshirë Ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme, z. Ditmir Bushati, Ambasadorin e BE-së në Tiranë dhe shumë vizitorë tjerë kryesorë nga rajoni: Mali i Zi, Kosova, Maqedonia, Greqia dhe Italia. Në të morën pjesë mbi 250 pjesëmarrës.

Arsyeja kryesore për organizimin e këtij aktiviteti është fakti që strukturat që koordinojnë Programet e Bashkëpunimit Territorial japin të dhëna / statistika shumë inkurajuese për pjesëmarrjen e aplikantëve shqiptarë në thirrjet për projekt propozime, me një numër të kënaqshëm të institucioneve dhe organizatave të përfshira. Kështu, ka një interes në rritje të aktorëve shqiptarë në programet e financuara nga BE.



Seminari ishte i strukturuar në dy sesione: Pjesa e përfaqësuesve të lartë, ku të ftuarit kryesorë theksuan ndikimin pozitiv që bashkëpunimi territorial sjell në zgjerimin e bashkëpunimit midis vendeve të rajonit me njëri-tjetrin, midis vendeve të rajonit dhe shteteve anëtare të BE-së, duke promovuar kështu integritimin dhe intensifikimin e shkëmbimeve. Sesioni i dytë iu kushtua paneleve të diskutimit ku pjesëmarrësit u ndanë në dy grupe të ndryshme punuese (institucionet publike dhe organizatat e shoqërisë civile) dhe diskutuan vështirësitë dhe sfidat me të cilat ballafaqohen partnerët shqiptarë në këtë fushë.

Ky aktivitet ishte një platformë shumë e mirë për të ofruar mbështetje institucionale nga institucionet shqiptare për partnerët e përfshirë në këto projekte, si dhe një forum i dobishëm për të marrë mendimet e tyre mbi përmirësimet e mundshme të bazës ligjore në Shqipëri për të lehtësuar zbatimin e këtyre projekteve në aspekte të ndryshme.



**PROJEKTET E FINANCUARA NË  
KUADËR TË THIRRJES SË PARË PËR  
PROJEKT-PROPOZIME NË KUADËR  
TË PROGRAMIT IPA BNK MALI I ZI –  
KOSOVË 2011-2013**

Që nga Nëntori i vitit 2015 deri në Gusht të vitit 2017 janë zbatuar një seri projektesh të financuar në kuadër të Thirrjes së parë për projekt-propozime të IPA Programit BNK Mali i Zi – Kosovë 2011-2013. Përkatësisht, nën tri masa që mbulojnë mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe kohezionin social dhe iniciativat njerëzit për njerëzit, u financuan gjithsej 9 projekte:


- »» BORN – Natyra pa kufi;
- »» Ndërtimi i Përfshirjes Sociale përmes Arsimit;
- »» Valorizimi i produkteve ekologjike në zonën ndërkufitare;
- »» Shfrytëzimi i inovacionit dhe sipërmarrjes në rajonin ndërkufitar të Kosovës dhe Malit të Zi;
- »» Përmirësimi i Menaxhimit të Burimeve Ujore në Gjakovë dhe Bijelo Polje;
- »» Veprim i Përbashkët për Punë të Qëndrueshme;
- »» Rivitalizimi i komuniteteve lokale për turizëm dhe zhvillim të të rinjve;
- »» Turizmi rural për zhvillimin ekonomik të zonës ndërkufitare të Kosovës dhe Malit të Zi;
- »» Nëpërmjet majeve të Alpeve Dinarike.

### **BORN - Natyra pa kufi**

*BORN - Natyra pa kufi - Mbrojtja e biodiversitetit dhe zhvillimi i parkut natyror Prokletije / Bjeshkët e Nemuna është një projekt i financuar nga BE dhe zbatuar nga Komuna e Plavës dhe Qendra për Zhvillim Rajonal në Rozhajë nga Mali i Zi dhe Trentino con il Kosovo nga Peja dhe Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit nga Prishtina, Kosovë.*



U bënë përpjekje të përbashkëta për të përcaktuar dhe thëlluar njohuritë e florës dhe faunës në habitatet e Parqeve Natyrore të Prokletisë (Mali i Zi) dhe Bjeshkëve të Nemuna (Kosovë). Për më tepër, qëllimi ishte identifikimi i nevojave të menaxhimit për



Vizita ne terren – Identifikimi i llojëve – Fotografi nga aktiviteti në kuadër të projektit BORN

këto fusha. Parqet Natyrore Prokletije dhe Bjeshkët e Nemuna janë zona të peizazhit unik, një nga rajonet më të rëndësishme për mbrojtjen e biodiversitetit në Ballkan dhe në tërë Evropën.

Gjatë gjithë projektit aktorët lokal u mbështetën në zbatimin e projekteve të zhvillimit të qëndrueshëm në lidhje me rritjen e burimeve natyrore. Përveç kësaj, kapacitetet e tyre u zgjeruan përmes organizimit të një udhëtimi studimor në Itali.

Një dokument strategjik ndërkufitar për përcaktimin e politikave të përbashkëta për menaxhimin optimal të zonës së projektit dhe ngritjen e vetëdijes së shoqërisë u krijua si një produkt i prekshëm. Përveç kësaj, u zbatuan aktivitetet e mëposhtme: Zhvillimi dhe përmirësimi i shtegut kryesor; Zhvillimi i Zonave të reja të Ngjites së Shkëmbinjve; Shtigje me biçikleta malore; Punëtori arsimor dhe udhëtime në terren për 6 shkolla.

Arritja më e rëndësishme e projektit ishte edhe krijimi i WEBGIS.

Për më shumë informacione klikoni [këtu](#).

### **Ndërtimi i Përfshirjes Sociale përmes Arsimit**

Ky projekt u zbatua nga Qendra për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut - CEDEM, Qendra Pedagogjike e Malit të Zi dhe OJQ Enfants nga Mali i Zi dhe Qendra Kosovare e Edukimit KEC dhe Shërbimet e të Krishterëve të Bethany - BCS nga Kosova. Qëllimi i projektit ishte përforcimi i kapaciteteve të OJQ-ve që merren me çështjet e romëve, ashkallinjëve dhe egjiptianëve për t'u

angazhuar në dialog me institucionet arsimore dhe për t'ju përgjigjur më mirë prioriteteve të përfaqësuesve të tyre në fushën e arsimit.

Domethënë, projekti nxiti të mësuarit nga bashkëmoshatarët, shkëmbimin e njohurive dhe partneritetin midis OJQ-ve me përvojë në zonën ndërkufitare, në mënyrë që të mbështesin përpjekjet e gjithëpërfshirjes në fushën e arsimit. Gjatë periudhës së zbatimit u krijua një rrjet joformal i palëve të interesuar të komuniteteve RAE.



Është organizuar një trajnim për Menaxhimin e Ciklit të Projektit për 21 OJQ, si dhe trajnime për përforcimin e aftësive prindërore në lidhje me arsimin dhe pjesëmarrjen në strukturat arsimore. Kjo i mundësoi përfaqësuesit e organizatave lokale që të fitojnë aftësi për të punuar në aspektin e përfshirjes sociale dhe të ofrojnë shërbime më të mira për fëmijët e komunitetit RAE me qëllim që të përmirësojnë aftësitë e tyre prindërore dhe pjesëmarrjen në sistemin arsimor (këshillat e shkollave dhe këshillat e prindërve). Përveç kësaj, u mbajtën trajnime për mësuesit për politikatat kundër diskriminimit. U zbatuan një sërë aktivitetesh

të tjera që synonin ngritjen e kapaciteteve të grupit të tyre të synuar: U krijua Rregullorja për Veprim Afirmativ në arsim për nxënësit RAE; Vizita studimore për të nxitur rrjetëzimin dhe shkëmbimin e informacioneve; Vlerësimi i nevojave; rregulla për menaxhimin e braktisjes, arsimin parashkollor dhe shkollor, etj.

Projekti krijoi një bazë solide për ndërhyrjet e mundshme në nivel politik dhe institucional brenda kësaj zone të ndërhyrjes. Mbështetjet dhe asistencë për ngritjen e kapaciteteve u është ofruar OJQ-ve nga rajoni ndërkufitar, nëpërmjet trajnimit dhe mentorimit.

### *Valorizimi i produkteve ekologjike në zonën ndërkufitare*

Komuna e Bijello Poles dhe Transmetuesi Lokal Radio Bijello Pole nga Mali i Zi dhe Komuna e Deçanit dhe Grupi i Veprimtari Lokal Gjeravica nga Kosova zbatuan projektin Valorizimi i Eko produkteve në Zonën Ndërkufitare. Qëllimi i projektit ishte të mbështeste zhvillimin dhe promovimin e eko-produkteve në zonën ndërkufitare.




Kjo është bërë nëpërmjet rinovimit të infrastrukturës së eko-tregut, prokurimit të pajisjeve për eko-tregjet në zonën e ndërkufitare, instalimit të paneleve diellore dhe ndriçimit në tregjet e eko-produkteve, prokurimit të kazanëve të mbeturinave të ngurta për eko-tregjet, hartëzimin e produkteve ekologjike lokale në zonën ndërkufitare, trajnimin për prodhimin dhe grumbullimin e produkteve ekologjike në zonën e ndërkufitare, trajnimin mbi aftësitë e marketingut dhe shitjes për prodhuesit lokal të produkteve ekologjike, promovimin e produkteve ekologjike si veprimtari alternative të gjenerimit ekonomik në zonën ndërkufitare, si dhe përmes një konkurrence të prodhimeve më të mira ekologjike në eko-tregjet në zonën ndërkufitare.

Përfituesit mbeten të përkushtuar ndaj zhvillimit të eko-prodhimit dhe do të zbatojnë dhe financojnë vazhdimisht

aktivitete që do të mbështesin zhvillimin e produkteve ekologjike në zonën ndërkufitare. Në këtë drejtim, për shkak të aktivitetëve të ndërtimit të kapaciteteve përmes projektit, efikasiteti i burimeve njerëzore që merren me këto politika rritet dhe sigurohet.

palët e tjera të interesuara si OJQ-të, bizneset si një ambient i përshtatshëm për zbatimin e trajnimeve të ndryshme. Përmes mbështetjes së projektit për promovimin e produkteve / shërbimeve rajonale janë siguruar organizimi i ngjarjeve dhe aktivitetëve ndërkufitare. Përveç kësaj, u organizuan gara për produkte



### *Shfrytëzimi i inovacionit dhe sipërmarrjes në rajonin ndërkufitar të Kosovës dhe Malit të Zi*

Ky projekt u zbatua nga Organizata Turistike Berane dhe IT Cluster Montenegro nga Mali i Zi dhe Shoqata e TIK ICT (STIKK) dhe Syri i Vizionit (SiV) nga Kosova. Qëllimet specifike të projektit ishin rritja e mirëqenies duke gjeneruar mundësi të reja biznesi dhe punësimi, si dhe rritja e mundësive për shfrytëzim më të mirë të burimeve lokale.



Përmes projektit u krijua një platformë për themelimin e Qendrës për Inovacionin e Bashkëpunimit Ndërkufitar. Rrjedhimisht, u kompletua funksionalizimi i Qendrave të Inovacionit për Kosovën dhe Malin e Zi. Qendrat e Inovacionit të BNKo-së u hapën në Berane dhe Istok dhe shërbejnë si hapësira bashkëpunuese për të rinjtë e rajonit dhe

dhe shërbime të teknologjisë dhe turizmit me qëllim të mbështetjes së ndërkombëtarizimit të ofertave turistike. Trajnimet për menaxhimin e ciklit të projektit dhe mjetet e promovimit digjital (p.sh. Airbnb, TripAdvisor, Facebook, etj.) u mbajtën në Korrik dhe Gusht të vitit 2016. Si rezultat, nëntë kompani fillestare janë prezantuar në faqet dhe portalet turistike të njohura (TripAdvisor, Airbnb, prenotim, aventurat e Malit të Zi, akomodimi i Malit të Zi, etj). Për më shumë informacione klikoni [këtu](#).

### *Përmirësimi i Menaxhimit të Burimeve Ujore në Gjakovë dhe Bijelo Polje*

Përmirësimi i Menaxhimit të Burimeve Ujore në Gjakovë dhe Bijelo Polje ishte një projekt i zbatuar nga Ujësjetësi "Bistrica" Bijelo Polje dhe Shoqata për avancim dhe trajtim të ujësjetësit dhe mbeturinave të ujit nga Mali i Zi dhe Qendra për Zhvillimin e Kosovës dhe Kompania Rajonale e Ujësjetësit "Radoniq"



Gjakovë nga Kosova.

Qëllimi i projektit ishte përmirësimi i mbrojtjes dhe menaxhimi i burimeve ujore natyrore në komunat e Gjakovës dhe Bijello Poles. Një nga aktivitetet kryesore ishte kryerja e studimeve të fizibilitetit për futjen e sistemit GIS (sistemi gjeografik i informacionit) në menaxhimin e ujërave në Gjakovë dhe Bijelo Polje.

### FAKTE TË SHPEJTA - GIS

**Sistemi i informacionit gjeografik - Software GIS është projektuar për të zënë, menaxhuar, analizuar dhe shfaqur të gjitha format e informacionit të referuar gjeografikisht.**

Pas kësaj është bërë prokurimi dhe aplikimi i sistemit GIS dhe pajisjeve përkatëse për ndërmarrjet e furnizimit me ujë në Gjakovë dhe Bijello Pole. Punonjësit e ndërmarrjeve të ujit të Gjakovës dhe Bijello Poles morën pjesë në trajnime mbi menaxhimin e sistemit GIS. Si vazhdim i trajnimeve u regjistruan sistemet e furnizimit me ujë dhe të dhënat hynë në GIS në Gjakovë dhe Bijello Pole. U mbajtën konsultime për humbjen e ujit dhe ngarkimin në ndërmarrjet e ujësllësve në Gjakovë dhe Bijello Pole. U zhvillua një fushatë e gjerë për ndërgjegjësimin e publikut mbi shfrytëzimin e ujit.

Me këtë projekt punonjësit e ndërmarrjeve ujore Gjakovë dhe Bijello Pole morën përvojë të konsiderueshme, ngritën kapacitetet e tyre njerëzore dhe teknike për të vazhduar me grumbullimin e të dhënave relevante të GIS nga e gjithë zona e sistemit të furnizimit me ujë, kryerjen e llogaritjes së rrjedhjes dhe llogaritjen e humbjeve.

### Veprim i Përbashkët për Punë të Qëndrueshme

Ky projekt u zbatua nga Agjencia e Punësimit të Malit të Zi dhe OJQ Natura nga Mali i Zi dhe Agjencia për Promovimin e Punësimit dhe OJQ Jeta nga Kosova. Qëllimi i projektit ishte heqja e pengesave dhe ofrimi i kushteve për punësimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore në rajonin ndërkufitar. Për më tepër, qëllimi i projektit ishte rritja e fleksibilitetit të forcës së punës dhe sigurimi i cilësisë më të mirë të jetesës në rajonin ndërkufitar.

Aktivitetet kryesore ishin: Përgatitja e përbashkët e një dokumenti të vetëm me rekomandime për performancën më të mirë të ES; Organizimi dhe zbatimi i dy vizitave

studimore një-ditore; Organizimi dhe zbatimi i dy seminareve njëditore për shkëmbimin e përvojave; Përgatitja dhe zbatimi i anketës pilot për të evidentuar nevojat e punëdhënësve; Organizimi dhe zbatimi i dy panairëve të punësimit ndërkufitar; Organizimi dhe zbatimi i dy tryezave të rrumbullakëta me punëdhënësit për të prezantuar dhe diskutuar rezultatet e hulumtimit; Përgatitja dhe shpërndarja e një dokumenti të përbashkët mbi rezultatet e sondazhit ndërkufitar dhe përgatitja dhe shpërndarja e materialeve të tjera promovuese. Aktiviteti më i rëndësishëm ishte organizimi i një trajnimi prej 22 ditëve të punës për të papunësuarit lidhur me prodhimin, përpunimin dhe promovimin komercial të bimëve mjekësore dhe prodhimeve pyjore. Përveç kësaj, u organizuan dy seminare për të papunët për të filluar biznesin e tyre dhe për të aplikuar për fonde / burime për të filluar biznesin e tyre.



### Rivitalizimi i komuniteteve lokale për turizëm dhe zhvillim të rinjë

*Rivitalizimi i Komuniteteve Lokale për Turizmin dhe Zhvillimin e Rinisë u zbatua nga Komuna e Andrijevicës dhe Shoqata e Studentëve*

Sportist të Malit të Zi dhe Komuna e Junikut dhe Fondacioni MDA nga Kosova. Qëllimi i projektit ishte nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm dhe promovimi i turizmit në Junik dhe Andrijevicë nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës dhe fuqizimit të rinisë. Kjo është arritur duke rehabilituar dhe pajisur hotelin e studentëve në Andrijevicë (klikoni këtu për më shumë informata), ndërtimin e një objekti sportiv me shumë qëllime në Parkun Moronica në Junik, sigurimin e pajisjeve sportive për aktivitetet malore /në natyrë për objektin sportiv për shumë qëllime në Junik dhe hotelin studentor në Andrijevicë dhe ndërtimin e një mulliri të vjetër tradicional "Valavica" në Junik.



Përveç kësaj, u organizua një aktivitet i përbashkët i ndërtimit të kapaciteteve për menaxhimin e qëndrueshëm të hapësirave ekzistuese dhe të sapo ndërtuara turistike. Për më tepër, ata së bashku kanë punuar në zhvillimin e një plani të shëndoshë dhe realist të menaxhimit të objekteve të reja, organizimin e kampeve Verore të të Rinjëve nga zonat ndërkufitare dhe zhvillimin e faqes së internetit, promovuese dhe interaktive, për hotelin studentor në Andrijevicë. Me këtë veprim, kapacitetet e infrastrukturës së komunave të Andrijevicës dhe Junikut për turizmin janë rritur. Me këtë projekt janë



promovuar atraksionet e turizmit në natyrë të Junikut dhe Andrijevicës.

### Turizmi rural për zhvillimin ekonomik të zonës ndërkufitare të Kosovës dhe Malit të Zi

Turizmi rural për zhvillimin ekonomik të zonës ndërkufitare të Kosovës dhe Malit të Zi u zbatua nga Agjencia Rajonale e Zhvillimit dhe Komuna Berane nga Mali i Zi dhe Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë në Kosovë.



Qëllimi i projektit ishte promovimi i zhvillimit ekonomik të zonës ndërkufitare përmes valorizimit ekonomik të potencialeve të saj turistike dhe të qëndrueshme të bujqësisë dhe pylltarisë.

Aktivitetet kryesore të projektit ishin krijimi i gjurmës tematike ndërkufitare, ngritja e paneleve diellore dhe pajisjet për mjelje në fshatrat malor, ngritja e 10 pikave të pushimit dhe 10 kampe në rrugë, instalimi i 10 vendeve të ushqyerjes për kafshët e egra, ndërtimi i Qendrave informative për vizitorët, trajnime për ofrimin e shërbimeve turistike në zonën ndërkufitare, trajnime për sigurinë ushqimore dhe teknologjinë e prodhimit, ngritja e pikave informuese në fshatrat malor dhe tabelave informuese të gjurmëve, udhëtimi i familjarizimit për agjencitë turistike dhe gazetarët, zhvillimi i marketingut, platforma ueb (<http://www.katunroads.me/en/>), si dhe hartimi i florës dhe faunës së rëndësishme në zonën e projektit.



Me këtë projekt është përmirësuar infrastruktura për zhvillimin e turizmit, janë rritur kapacitetet për shërbimet e turizmit të popullsisë rurale në rrugë dhe vlerat unike të

rrugëve si nxitës për bujqësinë dhe zhvillimin e turizmit.

#### FAKTE TË SHPEJTA – KATUNET

Katunet janë vendbanime të përkohshme, të fermerëve në male, në lartësi të larta, ku barinjët lëvizin bagëtinë e tyre për të kullotur në verë. Tradita e barinjve që lëvizin lart në male është e gjatë, dhe mënyra nomade e jetës ka zhvilluar gjatë gjithë historisë një kulturë dhe zakone të posaçme unike vetëm për katunët. Në kohën e tanishme kjo lëvizje e bagëtisë në katun praktikohet gjithnjë e më pak çdo vit, por kjo traditë vazhdon të ruhet. Pasi që turizmi malor në Mal të Zi rritet dhe zhvillohet, barinjët e katunëve u bënë pjesë e ofertës turistike për disa arsye.

Për më shumë informacione klikoni [këtu](#).

#### Nëprëmjet majeve të Alpeve Dinarike - ViP Dinarica

Ky projekt u zbatua nga Qendra për Iniciativa të Turizmit të Qëndrueshëm (CSTI), Shoqata Malore e Malit të Zi (MAM) dhe Fondi për Zhvillimin e Komunitetit dhe Klubi i Orientimit Prishtina nga Kosova. Qëllimi i projektit ishte zhvillimi i ViP Dinarica, një gjurmë në distancë dhe paketë turistike që lidh komunitetet malore dhe aktorët e turizmit në rajonin e synuar për valorizimin e pasurisë unike natyrore dhe trashëgiminë

kulturore-historike.

Aktivitetet e projektit ishin për të përmirësuar infrastrukturën e turizmit të vogël, hartimin dhe krijimin e marrëveshjeve me shitësit ekzistues turistikë dhe ofruesit e shërbimeve.



Për më tepër, qëllimi ishte zhvillimi i ofertës turistike ViP Dinarica. Kjo është bërë përmes mapimit dhe ndjekjes me GPS të rrugëve në rajonin ndërkufitar. Disa aktivitete u përqendruan në ndërtimin e kapaciteteve të klubeve alpiniste në Kosovë dhe Mal të Zi.

#### FAKTE TË SHPEJTA – THIRRJA E PARË NË KUADËR TË PROGRAMIT TË BNK-SË MZ-KS 2011- 2013

**78%** e granteve të dhëna si rezultat i Programit IPA të BNK-së, MZ-KS 2011-2013, ishin brenda Masës 1.2 - Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik.



**Praktika më e mirë - Projekte të zbatuara në kuadër të Programit IPA BNK Shqipëri - Mali i Zi 2007-2013**

Që nga janari i vitit 2009, kur Zyra e Sekretariatit të Përbashkët Teknik dhe ekipi u bë funksional në kuadër të Programit IPA BNK Shqipëri-Mali i Zi 2007-2013, deri në Shkurt të vitit 2016, kur u organizua Konferenca e Mbylljes, u shpallën 3 Thirrje për projekt-propozime dhe u zgjodhën 24 projekte të cilat u financuan dhe u zbatuan me sukses. Në kuadër të Thirrjes së parë të lançuar më 29 Qershor dhe të mbyllur më 29 Shtator të vitit 2009, u dorëzuan 26 projekt-propozime dhe 6 prej tyre janë financuar, duke mbuluar të tre masat e programit. Thirrja e dytë u hap më 29 Qershor dhe u mbyll më 14 Tetor të vitit 2010. U dorëzuan 42 projekt-propozime, nga të cilët 11 janë financuar. Thirrja e tretë dhe e fundit u lançua më 3 shtator dhe u mbyll më 3 dhjetor të vitit 2012. Në kuadër të kësaj thirrje janë dorëzuar 70 projekt-propozime dhe prej tyre 7 janë përzgjedhur dhe financuar.

Në total, në kuadër të Programit IPA BNK Shqipëri-Mali i Zi 2007-2013, janë paraqitur 138 propozime projektesh dhe janë financuar 24 projekte, 9 prej tyre nën masën së parë të programit "Zhvillimi ekonomik me theks në promovimin e turizmit"; 8 nën masën e dytë "Mbrotjtja dhe promovimi i mjedisit" dhe 7 nën masën e tretë „Rritja e kohezionit social përmes veprimeve njerëz me njerëz". Përveç kësaj, u financua një projekt strategjik, i quajtur "Rindërtimi i Pikë Kalimit Kufitar (PKK) ekzistues Hani i Hotit-Bozhaj dhe ndërtimi i PKK-së së re Grabom – Cemi i Trieshit".

Katër projekte u veçuan si shembuj të praktikave më të mira.

### **Simpoziumi i skulpturës**

*Simpoziumi i skulpturës* ishte një projekt i përzgjedhur nën Thirrjen e parë të IPA BNK Shqipëri - Mali i Zi 2007-2013 dhe është zbatuar nga Bashkia Shkodër, Shqipëri dhe OJQ ART Dulcinium nga Mali i Zi.



Ishte hera e parë që skulptorët nga të dyja anët e kufirit u bashkuan për të punuar për qytetet respektive, duke dhënë një shembull permanent për të bërë art të ri në kontekstin e ri të marrëdhënieve kulturore ndërkufitare.

Qëllimi i projektit ishte të kontribuonte në zbatimin e një praktike shkëmbimi midis artistëve nga Shqipëria dhe Mali i Zi. Aksioni lehtësoi qartë këtë shkëmbim gjatë periudhës së zbatimit. Aktivitetet kryesore të projektit ishin krijimi i 20 skulpturave publike përmes simpoziumeve të skulpturës, instalimi i këtyre skulpturave në parqet publike dhe krijimi i një katalogu skulpturor.

Gjatë gjithë përpunimit të skulpturave, publiku i gjerë dhe ai i artistëve kishin mundësinë për të parë edhe procesin e punës dhe jo vetëm punën e përfunduar. Kjo e bëri simpoziumin atraksion të përditshëm për masa të gjëra gjatë kohëzgjatjes së tij.



Ky projekt krijoi bazën për bashkëpunimin e ardhshëm kulturorë midis artistëve. Për më tepër, skulpturat e prodhuara ende dekorojnë parqet publike në Shkodër dhe Ulqin. Simpoziumi i skulpturës krijoi diskutime pozitive midis artistëve dhe pati përpjekje serioze për të replikuar këtë veprim në qytete të tjera shqiptare dhe malazeze.

### **Turizmi i fermës: Zhvillimi i agro-turizmit në Shqipërinë Veriore dhe Malin e Zi Lindor**

Ky ishte një projekt i përzgjedhur nën thirrjen e dytë të programit IPA BNK Shqipëri-Mali i Zi 2007-2013 dhe u zbatua nga Programi i Mbështetjes së Shoqatave Rurale (RASP) në Shqipëri dhe Organizata Rajonale Turistike Bjelasica dhe Komovi në Mal të Zi.

Qëllimi i projektit ishte zhvillimi dhe promovimi i turizmit të qëndrueshëm nëpërmjet krijimit të aktiviteteve pilot agroturistike në rajonin ndërkufitar të Shqipërisë së Veriut dhe Malit të Zi Lindor, bazuar në përdorimin e burimeve natyrore dhe kulturore dhe përfshirjen e gjerë të qeverive lokale. U përzgjodhën 21 fermerë (11 në Shqipëri dhe 10 në Mal të Zi), të asistuar dhe të mbështetur për të përmirësuar kapacitetet prodhuese përmes sigurimit të teknologjisë së re, rritjes së kapaciteteve të

menaxhimit dhe akomodimit dhe përmirësimit të cilësisë së produkteve vendore në përputhje me kërkesat e sigurisë ushqimore.

Përveç kësaj, për të përmirësuar ofertën turistike dhe promovimin e produkteve tradicionale vendore u organizua ndërtimi i kapaciteteve (trajtime) për fermtat pilot në përmirësimin e teknologjisë, menaxhimit, mikpritjes dhe marketingut, tre panaire lokale dhe tri zyre informative turistike u ngritën në komunat Margegaj, Fierzë dhe Shishtavec.



Gjatë gjithë projektit, aktorët lokalë u mbështetën për të përmirësuar dhe promovuar produktet e tyre, për të shkëmbyer përvojën me homologët e tyre dhe për të realizuar më mirë potencialet e tyre turistike. Për më tepër, u krijua një rrjet prodhuesish lokalë, lehtësira akomodimi, udhëzues turistikë, biznese vendore dhe kombëtare dhe partnerët e tyre në anën tjetër të kufirit, duke synuar të ndihmonin dhe të mbështesin ekonominë lokale.

### **MARUBI: një model bashkëpunimi për promovimin e turizmit midis Shkodrës dhe Ulqinit**

Projekti *MARUBI* u përzgjedh nën Thirrjen e dytë të IPA BNK Shqipëri - Mali i Zi 2007-2013 dhe u zbatua nga Bashkia e Shkodrës dhe Komuna e Ulqinit.

Qëllimi i projektit ishte rritja e zhvillimit ekonomik të zonës së Shkodrës dhe të Ulqinit duke u mbështetur në potencialet e tyre turistike dhe duke theksuar trashëgiminë e përbashkët kulturore (në veçanti, pasurinë e fotografëve Marubi) dhe bukurinë natyrore të zonës.

Për të promovuar zonën e Shkodrës dhe Ulqinit si një destinacion turistik, projekti ka synuar të forcojë ofertën kulturore dhe ta bëjë atë më konkurruese përmes zhvillimit të formave të bashkëpunimit ndërmjet operatorëve lokalë dhe NVM-ve; për të zhvilluar praktika të reja turistike dhe për të



identifikuar grupe të reja të synuara për të rritur kërkesën e turizmit kulturor lokal. Aktivitetet kryesore të zbatuara gjatë projektit ishin:


- Regjistrimi strategjik i trashëgimisë së Marubit;
- Plani i fizibilitetit i rrugës Marubi;
- Kursi i trajnimit për operatorët ekonomik dhe turistik dhe të rinjtë;
- Marketingu ndër-kufitar territorial në nivel lokal/kombëtarë;
- Marketingu territorial në më shumë se 20 destinacione europiane.

Për më tepër, projekti kërkoi të shqyrtojë dhe klasifikojë pasurinë e familjes Marubi. Si rezultat i fushatës promovionale u mbledhën një numër i madh i fotografive Marubi, midis të cilave foto origjinale në xham.

### FAKTE TE SHPEJTA - Marubi

**Qytetarët e Shkodrës në mënyrë vullnetare kanë dhuruar më shumë se 1500 foto të panjohura gjatë fushatës promovuese të këtij projekti.**

Aktiviteti kryesor i Projektit Marubi ishte ekspozita shëtitëse "Duke reflektuar traditat tona, duke reflektuar veten", e cila u hap për herë të parë në Parlamentin Europian në Bruksel. Destinacionet ndërkombëtare të ekspozitës ishin: Paris, Trieste, Ankara, Varshavë, Gjenevë, Budapest, Beograd, Tiranë etj.



Përveç kësaj, në Shkodër dhe Ulqin u organizua edhe Festivali MARUBI, i përbërë nga konkurse fotografike, aktivitete kulturore (vallëzim popullor dhe shfaqje të këndimit) dhe punëtori të dedikuara për historinë e dinastisë MARUBI, teknikat e fotografisë, etj.

### *“Monteal” - Investim në rritje të qëndrueshme njerëzore, ekonomike dhe lokale përmes menaxhimit pjesëmarrës të turizmit në zonën ndërkufitare*

“Monteal” - Investim në rritje të qëndrueshme njerëzore, ekonomike dhe lokale përmes menaxhimit pjesëmarrës të turizmit në zonën ndërkufitare u përzgjodh në kuadër të Programit të tretë të IPA BNK Shqipëri-Mal të Zi 2007-2013 dhe u zbatua nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit në Shqipëri dhe Organizata Turistike Rajonale Bjelasica dhe Komovi në Mal të Zi.

Qëllimi i përgjithshëm i aksionit ishte zgjerimi i potencialeve të rritjes dhe prosperitetit për rajonet e Kelmendit, Shkrelit, Plavës, Andrijevicës dhe Beranes përmes diversifikimit të ekonomive të tyre lokale dhe zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm. Aktivitetet kryesore të projektit ishin krijimi i planit të zhvillimit të turizmit ndërkufitar dhe Bordit të Partneritetit Ndërkufitar për zonën ndërkufitare të synuar, zhvillimi i një produkti lokal turistik i cili mund të mund të adaptohet dhe të lidhet me atraksionet / aktivitetet

turistike në zonën ndërkufitare të synuar nëpërmjet përmirësimeve të infrastrukturës nga të dy zonat, zhvillimin e një baze dokumentacioni të burimeve kulturore, historike dhe natyrore në zonën ndërkufitare të synuar.

Për më tepër, një ofertë e përbashkët turistike që lidh aktivitetet në komunitetet e synuara dërrjetet e biznesit të turizmit në të dy anët e kufirit u krijua dhe u promovua. Përmes aktiviteteve të projektit, komunitetet lokale,

operatorët turistikë dhe biznesi përfituan drejtpërdrejt. Në Kelmend dhe Theth janë



ndërtuar gjithsej 8 pika për pamje panoramike, janë ndërtuar dhe instaluar 8 tabela informative, janë ndërtuar 10 vende pushimi, janë riparuar 96 km rrugë malore, është ndërtuar një qendër informacioni në Andrijevicë dhe një dritare interaktive (touch board) është instaluar në Berane, etj.

MONTEAL tërhoqi vëmendjen e institucioneve kombëtare drejt një qasje pozitive dhe konstruktive. Projekti ka rritur numrin e vizitorëve në zonë, duke siguruar një konsolidim të vazhdueshëm të lidhjeve të biznesit, komunitetit dhe turizmit me asetet turistike të identifikuara, promovuara dhe të përdorura nga vizitorët..

Përveç kësaj, projekti MONTEAL krijoi dhe promovoi një hartë të re të atraksioneve turistike për t'u vizituar në zonën e projektit dhe ishte një shembull pozitiv për përsëritjen e mëtejshme në zonat e tjera fqinje.

**Mbledhjet e mbajtura në  
kuadër të programeve IPA  
BNK MZ-SHQ dhe MZ-KS  
2014-2020**

***U mbajt takimi i 4-të  
bilateral ndërmjet  
Strukturave Operative të  
Malit të Zi dhe Republikës së  
Kosovës***

Takimi i 4-të ndërmjet Strukturave Operative të Malit të Zi dhe Republikës së Kosovës në kuadër të Programit IPA BNK Mali i Zi – Kosovë është mbajtur në Podgoricë me 30 Nëntor të vitit 2017. Në takim morën pjesë anëtarët e Strukturës operative nga Mali i Zi dhe Kosova, si dhe anëtarët e Sekretariatit të Përbashkët Teknik dhe të Zyrës Antenë të



programit.

Në emër të Strukturës operative të Malit të Zi takimin e udhëhoqi znj. Ivana Glisević Đurović, Drejtore e Përgjithshme për Fondet Evropiane në Ministrinë për Çështje Evropiane, ndërsa në emër të Strukturës operative të Kosovës znj. Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Në këtë takim u vlerësua realizimi i suksesshëm i programit dhe se një numër i madh i aktiviteteve janë realizuar pas nënshkrimit të Marrëveshjes Bilaterale dhe asaj të Partneritetit dhe se projektet janë duke u vlerësua në kuadër të thirrjes së parë për projekt propozime.

Po ashtu në këtë takim u raportua edhe për aktivitetet e kryera, rezultatet dhe progresin në zbatimin e Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA Mali i Zi - Kosovë. Gjithashtu, janë diskutuar edhe metodat e përmirësimit të komunikimit dhe të vizibilitetit të Programit dhe rezultatet aktuale në këtë fushë gjithashtu. Aktivitetet janë të planifikuara për periudhën e ardhshme, duke përfshirë këtu edhe intensifikimin e komunikimit dhe shkëmbimit të përvojave ndërmjet strukturave operative.



***Takimi i dytë i Komitetit të  
Përbashkët Monitorues në  
kuadër të Programit IPA BNK  
Mali i Zi - Shqipëri 2014-2020***

Takimi i Dytë i Komitetit të Përbashkët Monitorues (KPM) të programit IPA BNK MZ-SHQ 2014-2020 u zhvillua në hapësirat e Ministrisë për Evropën dhe Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë, në Tiranë më 29 Dhjetor të vitit 2017.

Znj. Daniela Çekani, drejtuese e takimit të dytë të KPM-së dhe Drejtuese e Strukturës Operative të Shqipërisë, mirëpriti të gjithë pjesëmarrësit dhe prezantoi shkurtimisht programin, prioritetet tematike dhe aktivitetet e ndërlidhura që janë zbatuar brenda programit, duke theksuar numrin e madh të aplikimeve të pranuar dhe interesin e madh në mundësitë e ofruara nga programi.



Në emër të Ministrisë së Çështjeve Evropiane të Malit të Zi, z. Miodrag Raçeta përshëndeti pjesëmarrësit e takimit. Ai theksoi performancën profesionale të CFCU gjatë procesit të vlerësimit dhe mbështetjen e madhe të Sekretariatit të Përbashkët Teknik (SPT) gjatë zbatimit të programit.

Tema kryesore e këtij takimi ishte prezantimi i listës së projekteve të përzgjedhura përmes Thirrjes së Parë për Projekt – propozime, për dhënien e kontratës së granteve në kuadër të programit IPA BNK MZ - SHQ 2014-2020, si dhe ekzaminimin dhe dhënien e mendimit këshillimor nga anëtarët e KPM-së.

***U mbajt takimi i pestë i  
Komitetit Drejtues të  
Projektit***

Takimi i Pestë i Komitetit Drejtues të Projektit u mbajt në Podgoricë, në Mal të Zi, me 31 Janar të vitit 2018, brenda hapësirave të SPT-së.

Është diskutuar për zbatimin e mëtejshëm të Programeve Mali i Zi - Shqipëri dhe Mali i Zi - Kosovë 2014-2020, si dhe për aktivitetet e ardhshme në gjysmën e parë të vitit 2018. Për më tepër, u diskutuan aktivitetet e zbatuara dhe u vlerësua cilësia e rezultateve të arritura të projektit nga anëtarët e Komiteti Drejtues i Projektit.



***Zbatimi i programeve deri në  
fund të vitit 2017***

Deri në fund të vitit 2017 u organizuan një sërë aktivitete në të dy programet IPA BNK. Këto ngjarje u organizuan nga Ministria e Çështjeve Evropiane e Malit të Zi, Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal të Republikës së Kosovës, Ministria e Financave Mali i Zi - Drejtoria për Financimin dhe Kontraktimin e fondeve ndihmëse të BE-së dhe Sekretariati i Përbashkët Teknik i Programeve IPA BNK Mali i Zi - Shqipëri dhe Mali i Zi - Kosovë 2014-2020.

Grafiku më poshtë tregon arritjet e të dy programeve gjatë periudhës 2016-2017.



**MNE - ALB**  
IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR  
MALI I ZI – SHQIPËRI 2014-2020

**MNE - KOS**  
IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR  
MALI I ZI – KOSOVË 2014-2020

Ky projekt është i financuar nga Bashkimi Evropian

»» Strukturat operative të programeve (klikoni në ikonën për të vizituar faqen e internetit):



Ministry of European Affairs



Ministry of finance  
Directorate for Finance and Contracting  
of the EU Assistance Funds



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
  
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave  
Ministry of Local Government Administration



**SEKRETARIATI I PËRBASHKËT TEKNIK I IPA  
PROGRAMEVE TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR  
MALI I ZI – SHQIPËRI DHE MALI I ZI – KOSOVË 2014–2020**

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra kryesore**  
Adresa: Beogradska 17, 81 000 Podgorica, Mal i Zi  
Telefon: + 382 20 240 784; + 382 20 240 631;

**Sanja TODOROVIC**

Drejtuese e Sekretariatit të Përbashkët Teknik  
E-mail: [sanja.todorovic@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:sanja.todorovic@jts-mne-alb-mne-kos.org)

**Maja RADOVIC**

Zyrtare për Prokurimet dhe Financat  
E-mail: [maja.radovic@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:maja.radovic@jts-mne-alb-mne-kos.org)

**Gazmir RACI**

Zyrtar Projekti, Antenë  
E-mail: [gazmir.raci@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:gazmir.raci@jts-mne-alb-mne-kos.org)

**Nikola DJONOVIC**

Zyrtar Projekti me Specializim në Komunikim  
E-mail: [nikola.djonovic@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:nikola.djonovic@jts-mne-alb-mne-kos.org)

**Almir CAUSEVIC**

Zyrtar Projekti me Specializim në IT  
E-mail: [almir.causevic@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:almir.causevic@jts-mne-alb-mne-kos.org)

**Petar BELADA**

Asistent Administrativ  
E-mail: [petar.belada@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:petar.belada@jts-mne-alb-mne-kos.org)

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra Antenë**  
Adresa: Rruga Ndoc Çoba, Nr 1 Shkodër, Shqipëri  
Telefon: + 355 22 80 20 80;

**Andi ÇEKAJ**

Zyrtar Projekti, Antenë  
E-mail: [andi.cekaj@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:andi.cekaj@jts-mne-alb-mne-kos.org)

[www.cbc-mne-alb.org](http://www.cbc-mne-alb.org) | [www.cbc-mne-kos.org](http://www.cbc-mne-kos.org)



Ky projekt është i financuar  
nga Bashkimi Evropian